



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	17.10.2024
REFERENC-Ë:	24/1818/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Zoggi", Sh.p.k., Malishevë, Shfrytëzim i gurit gëlqeror, Dresnik, Klinë.
	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Afrim Murati, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit, "Zoggi" Sh.p.k. Malishevë, me nr.prot. 24/1818/MMPHI, për veprimtarinë: Shfrytëzim i gurit gëlqeror, Dresnik, Klinë.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/1818/MMPHI
Datë: 13.09.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxje këtë:

V E N D I M

1. Operatori, "Zoggi", Sh.p.k., Malishevë, Shfrytëzim i gurit gëlqeror, Dresnik, Klinë, me nr.prot. 24/1818/MMPHI, **pajiset me Leje Mjedisore** për veprimtarinë: Shfrytëzim i gurit gëlqeror, në ngastrën nr. P-71010027-00857-3, në sipërfaqe prej 03.99.94 ha (39994m²), zona kadastrale Dresnik, Klinë.
2. Operatori obligohet:
 - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
 - 2.2. Të mirëmbahet thurja e ngastrës ku bëhet shfrytëzimi i gurit gëlqeror;
 - 2.3. Të i përmbahet kushteve të shfrytëzimit të gurit gëlqeror sipas përshkrimit në aplikacion;
 - 2.4. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit mjedisor;
 - 2.5. Vazhdimisht të behët spërkatja me ujë e rrugëve të pa asfaltuara të cilat shfrytëzohen për bartjes të gurit gëlqeror;

Faqe 2 nga 4

- 2.6. Gjatë përfundimit të shfrytëzimit në pjesë të ngastrës, të punohen etazhet për për përgatitje të rikultivimit;
- 2.7. Dhe pas përfundimit të aktivitetit të bëhet rehabilitimi dhe rikultivimi i zonës sipas Kontratës së lidhur me APK, si dhe kritereve të Pëlqimit Mjedisor;
- 2.8. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për operatorin, "Zoggi", Sh.p.k., Malishevë, me nr.pot.24/1818/MMPHI, për veprimtarinë: Shfrytëzim i gurit gëlqeror, Dresnik, Klinë, në ngastrën nr. P-71010027-00857-3, në sipërfaqe prej 03.99.94 ha (39994m²), zona kadastrale Dresnik, Klinë, konstatohet që operatori plotëson kriteret e parapara me Udhëzim Administrativ 04/2022/MMPHI, për Leje Mjedisore.


Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kritereve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit-ARBK;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 16/1734/1-ZSP/105/16, te lëshuar me datë: 19.05.2016;
- Licencë Shfrytëzimi me Nr. 1952/KPMM/2019, të protokolluar me nr. prot. 2185 të lëshuar me dt.19.06.2019, me afat të vlefshmërisë deri me 10.01.2029;
- Pëlqimin nga MBPZHR/ APK, për shfrytëzimin e tokës pyjore;
- Pëlqim nga K. Klinës për shfrytëzimin e parcelës.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.


Afrim Murati

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Klinë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së